



RÖFIX Renoplus®

Suva nivelimi dhe rinovimi universale

Udhëzime teknike dhe ligjore:

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skemat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit (UNI, ÖNORM, SIA, etj), si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve (p.sh. SMGV, ÖAP, QG -WDS).

Fushat e përdorimit:

Suva niveluese dhe rinovuese minerale për përdorim universal. Trashësia e një shtrese mund të variojë nga 3 deri 30 mm njëherësh. Për përpunimin e suvave të vjetra, por edhe në sektorin e mirëmbajtjes së monumenteve.

Masë përforcuese për rinovimin e suvave në fasada, në kombinim me rretën përforcuese RÖFIX P50. Suva niveluese për përmirësimin e suvave, bazamenteve të zakonshëm të ndërtimit.

Të mos përdoret në zonën e xokolaturës dhe në zonat në kontakt me ujën.

Nuk duhet të përdoret për ngjitjen e pllakave të termoizolimit.

Për përpunimin e suvave të vjetra mbajtëse (edhe finot e lëngshme me bazë alkalike) dhe mbi bojra të vjetra mbajtëse si dhe mbi krisjet jo statike.

Veçanërisht i përshtatshëm për nivelimin e bazamenteve me aftësi thithëse dhe disnivele të ndryshme. Mund të përdoret në trashësi të ndryshme për suvatimin e kanalizimeve të kaloriferit, etj.


Pas lidhjes së plotë të suvasë mbushëse me murin aplikoni sipër vetëm fino minerale, me difuzion të lartë ndaj avujve t_v7 ujit si (RÖFIX - fino silikat/ silikoni si dhe SiSi RÖFIX).

Bazament optimal për bojra silikat apo gëlqerore.

Karakteristikat:

- Mënyrë e jashtëzakonshme aplikimi
- I përforcuar me fibra
- Ngjitje e mirë
- Tkurrje të pakta

Përpunimi:



Të dhëna teknike	
SAP-Art. Nr.:	2000148206
NAV-Art. Nr.:	119805
Lloji i paketimit	
Njesi per palete	48 Nj./Pal
Sasi për njësi	25 kg/Nj.
Kokrrizimi	0 - 1 mm
Konsumi	ca. 1,45 kg/m ² /mm
Udhëzime për përdorimin	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese, ato varen shumë nga karakteristikat e bazamentit dhe nga teknika e aplikimit. Kur zhvillohet punimi për herë të parë dhe në raste të aplikimit në sipërfaqe të mëdha këshillohet realizimi paraprakë në nje sipërfaqe prove.
Konsumi i ujit	ca. 7,5 l/Nj.
Trashësia minimale e suvasë	3 mm
Dëndësia në gjëndje të papërpunuar (EN 1015-11)	ca. 1.300 kg/m ³
Percueshmeria ndaj avujve μ	15 - 20
Përcjellshmëria termike (EN 1745:2003)	0,45 W/mK (Tabellenwert) për P=50%
Përcjellshmëria termike (EN 1745:2003)	0,49 W/mK (Tabellenwert) für P=90%



RÖFIX Renoplus®

Suva nivelimi dhe rinovimi universale

Të dhëna teknike	
SAP-Art. Nr.:	2000148206
Kapaciteti termik	ca. 1 kJ/kg K
Forca në lidhje (EN 13279-2)	≥ 0,2 N/mm ²
Moduli-E	ca. 3.500 N/mm ²
Kapilariteti	≥ 2 kg/m ² 24h
GLI (EN 998-1)	GP W _c 0 CS II, i përshtatshëm për pllaka (ca. 3 N/mm ²)
Trashësia maksimale e shtresës	30 mm
Koha e tharjes	ca. 10 d
Këshilla për paketimin	Në thasë letre me mbrojtje kundër lagështisë.
Temperatura e bazamentit	> 5 - < 25 °C
Reaksioni ndaj zjarrit	A1

Baza e materialit:

- Gëlqere e pashuar
- Çimento e bardhë (pa kromat)
- Rërë gëlqerore fine me kokërrizë të rrumbullakët
- Me aditiv fibrash
- Aditivë shtesë për përmirësimin e aftësisë së përpunimit
- Përbërës organik < 5%

Kushtet e punimit:

Gjatë fazes së përpunimit dhe tharjes, ambjenti përreth sikurse dhe temperatura e bazamentit nuk duhet ulët nën +5° C dhe nuk duhet të ngrihet mbi +30° C.
Gjatë kohës së aplikimit dhe forcimit të materialit, mbrojeni minimumi për 7 ditë nga ngricat.

Bazamenti:

Sipërfaqet duhet të jenë të pastra, të fortë, pa lagështi të përhershme, pa pluhur, të qëndrueshme dhe të pa myke, vajra, graso, dhe të tjerë faktorë ndikues.
Testimi i bazamentit duhet të vijojë sipas ÖNORM B3346 ose DIN 18350 ose SIA V242.
Pjesë suvaje të dëmtuara eliminohet. Pjesë të lira ose të shkëputura në ndërtesa të vjetra të mbrojtura nga shteti, pastrohen vetëm duke marrë një miratim nga zyra përkatëse. Nëse këto pjesë nuk do të pastrohen ose zëvendësohen, atëherë duhet të ngjitsin përsëri në mënyrë profesionale.
Variantet e suvasë për mure me sisteme ngrohjeje janë të varura nga bazamenti i suvatimit, ose më saktë muri mbajtës i sistemit të ngrohjes.

Bazamenti-Trajtimi paraprak:

Para rinovimit të suvasë së vjetër duhet të bëhet testimi i bazamentit për aftësinë mbajtëse me anë të "provës së shkuljes". Për këtë bëhet prova në 2 vënde mbi fasadë nga 1m² ku bëhet aplikimi i llaçit me rretjen përforcuese RÖFIX të futur në të. Pas tharjes (të paktën 7 ditë) bëhet testimi i fasadës dhe gjykohet sipas udhëzuesëve të RÖFIX.
Suvatë apo shtresat e bojës pa aftësi mbajtëse duhet të eliminohen.
Pas montimit të sistemit të ngrohjes mbi bazamente minerale si mur me tulla me vrima, blloqe me vrima ose gurë të plotë, nuk është i nevojshëm asnjë trajtim paraprak i bazamentit.
Mbi sipërfaqe betoni te pastra dhe te thata nuk është e nevojshme lyerja me lende lidhese (ngjitese).
Në bazamentet organike pastrimi duhet të kryhet me anë të hedhjes së ujit dhe jo me anë të pastruesit me presion të lartë. Pas pastrimit lëreni bazamentin të thatet mjaftueshëm (rreth 10 ditë në kushte të mira atmosferike). Nëse bazamentet organike pastrohen me ujë me presion të lartë, koha e tharjes në këte rast zgjatet.
Bazamentet me qëndrueshmëri të ulët, me tendencë për të rënë mund të rigjenerohen ose të fortësohen me RÖFIX ujë gëlqeror ose RÖFIX PP 201 SILICA LF fiksues me silikat dhe hollues.



ROFIX Renoplus®

Suva nivelimi dhe rinovimi universale

Përgatitja:	Në rast „punimi me dorë“ përzieni një thes në makinerinë përzjerese me sasinë e nevojshme të ujit , në mënyrë që të formohet një masë e njëtrajtëshme. Pas përzjerjes lëreni 10 min. në qetësi dhe pastaj përziheni përsëri. Nëse materiali është fortësuar nuk përzihet më.
Përpunimi:	Në rast përpunimi me dorë, materjalin e perzierë shtojeni me mistiri apo vegël tjetër të përshtatshme. Në rastin e përdorimit si suva përforcuese me një trashësi afërsisht 3 mm, shtroni në mes rrjetën armuese ROFIX P50. Rrjeta armuese duhet të lihet nga çdo anë 10 cm më e gjatë. Në „aplikimin me makineri“ sprucojeni me pompën e suvasë. Më pas hiqni me mastar pjesët e tepërta Suvaja e aplikuar mund të strukturohet edhe direkt në shtresën e fundit me një mallë strukturoese
Këshilla:	Nuk është i përshtatshëm për ngjitjen në sipërfaqe të mëdha të pllakave qeramike ose pllakave të gurëve natyrorë. Shtrimi në sipërfaqe të vogla i pllakave në zona me rrjedhje ose lagje të pjesshme (si psh: kuzhina gatimi në ambjente shtëpie, tualete) është i mundur vetëm mbas një kohe tharrje të mjaftueshme (4 javë). Në zona me lagështirë (si psh: sektore me rrjedhshmëri uji të vazhdueshme) nuk sugjerohen suvatë e gëlqeres. Për të parandaluar rrezikun e formimit të plasaritjeve në suvatimet e sistemeve me ngrohje në mur, këshillohet zakonisht aplikimi i një armimi - suvasë + rrjetë. Për një rregullim të mirë të klimës së shtëpisë ju rekomandojmë bojrat me difuzion avujsh dhe dioksid karboni si ROFIX PE SESCO bojë me bazë gëlqere, ROFIX PI 233 ÖKOSIL ose PI 262 ÖKOSIL PLUS.
Këshilla në rast reziku:	Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.
Këshilla për përpunimin:	ROFIX Renoplus mund të strukturohet menjëherë. Llaçin e freskët punojeni brenda 2 orëve. Gjatë tharjes duhet të përdorni mjete për ngrohjen- që të krijohen kushte më të mira për tharjen dhe fortësimin (psh. me ventilues). Ngrohja e drejtpërdrejtë e suvasë nuk është e lejuar. Materialin e hapur ju lutem mos e përdorni, gjithashtu mos e përzieni me materialin e ri.
Magazinimi:	Magazinojeni në vende të thata mundësisht mbi paleta druri. Koha e magazinimit: min. 12 muaj sipas. Rregullores 1907/2006/EG, Aneksi XVII, në temperaturë 20 °C, 65 % lagështi ambjenti.
Deklaratë:	
Këshilla të përgjithshme:	Kjo skedë teknike anulon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme. Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkojnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme. Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në vetevete nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar. Produktet ROFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohet një cilësi e pandryshueshme. Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona. Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (www.roefix.com), ose mund të kërkohen edhe pranë filjaleve rajonale në vënd. Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.